

## 5.14 SHFAQJA E GABIMEVE NË SERVER

Ndërprerjet dhe gabimet e paparashikueshme që mund të ndodhin gjatë punës në program (p.sh. ndërprerja e komunikimit), regjistrohen në një skedar. Nëse merrni njoftimin për gabimin në server, njoftoni IZUM-in, i cili në bazë të përshkrimit të gabimit nga ana juaj eliminon shkaktarin e tij.

### *Procedura*

1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Serveri / Shfaq gabimet në server**.

Hapet dritarja me listën e gabimeve.

Hollësitë për gabimet e veçanta mund t'i shikoni nëse në listë përzgjidhni gabimin dhe më pas klikoni butonin **Detajet**.

Hapet dritarja **Gabimi** me përshkrimin e gabimit. Nëse në listë ndodhen disa gabime, nga njëri gabim në tjetrin kaloni përmes butonit **Tjetra** ose **Emëparshmja**. Dritaren e mbyllni përmes butonit **Në rregull**.

2. Klikoni butonin **Anulo**.